

- Kontakt për shoqatat apo organizata të cilat nuk janë organe kompetente, ndërsa nga të cilët dhënësit apo shfrytëzuesit e shërbimeve mund të marrin ndihmë praktike;
- Radhitja e hapave sipas të cilave më së shpeshti shqyrtohet një kërkesë, në mënyrë të lehtë dhe të kuptueshme;
- Por jo si këshillë juridike, por si formë e informacionit të përgjithshëm për hapat në një procedurë.



Për këshilla shtesë në lidhje me të drejtat Tuaja si konsumatorë, mund të drejtoheni tek Organizata e konsumatorëve të Maqedonisë OKM – Shkup, tel. 02/3 179 592 ose nëpërmjet ueb-faqes: www.opm.org.mk
E-mail: sovetuvanja@opm.org.mk



Република Северна Македонија
Министерство за економија

ÇFARË NA SJELLË LIGJI RI PËR SHËRBIME





Çka është shërbim?

“Shërbim” është aktivitet i pavarur ekonomik që bëhet për kompensim dhe nuk është i rregulluar me ligje dhe dispozita me të cilat rregullohet qarkullimi i mallrave, kapitalit dhe personave.

Çka është dhënës i shërbimit?

“Dhënës i shërbimit” është person fizik – shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut ose i ndonjë shteti nga hapësira ekonomike evropiane ose person juridik me seli të themeluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut apo në shtet të HEE që ofron ose jep shërbime.

Çka është pranues i shërbimit?

“Pranues i shërbimit” – është person fizik – shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut ose i ndonjë shteti nga HEE ose person juridik me seli të themeluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut apo në ndonjë shtet të HEE-së që shfrytëzon ose dëshiron të shfrytëzojë shërbim për qëllime profesionale apo jo formale.

Kush e ushtron funksionin e Pikës së vetme për kontakt?

Funksionin Pikë e vetme për kontakt në Republikën e Maqedonisë së Veriut e ushtron Portali Nacional për shërbime të cilin e zhvillon, administron dhe e mirëmban Ministria për shoqëri informatike dhe administratë, në pajtim me dispozitat për menaxhim elektronik dhe shërbime elektronike.

Çka u siguron Pika e vetme për kontakt personave të interesuar?

- Informata për procedurat dhe kushtet për qasje dhe dhënie të shërbimeve;
- Plotësim dhe parashtrim të formularëve dhe fletëparaqitjeve përkatëse të nevojshme për të marrë pëlqim nga organet kompetente të Republikës së Maqedonisë së Veriut për qasje dhe dhënie të shërbimeve, duke përfshirë edhe fletëparaqitje për regjistrim në regjistër, në katalog, bazën e të dhënave, ose për regjistrim në shoqatë profesionale;
- Përgjigje nga organet kompetente të Republikës së Maqedonisë së Veriut për kërkesë të parashtruar për pajtim për qasje dhe dhënie të shërbimeve.



Çfarë informata mund të sigurojnë kërkuessit e shërbimeve nëpërmjet Pikës së vetme për kontakt?

- Procedura ligjore për marrje të ndonjë pëlqimi për qasje dhe kryerje të shërbimeve, me përshkrim të procedurave ligjore dhe kërkesa të cilat duhet të plotësohen;
- Cili është organi kompetent për të zbatuar çdo procedurë për miratim që ekziston në Republikën e Maqedonisë së Veriut me adresë dhe kontakt - informata tjera për të njëjtin ;
- Mënyra dhe kushtet për qasje, personat e interesuar, të të dhënat e regjistruara në regjistrat publikë për ofruesit e shërbimeve dhe për shërbimet si të tilla;
- Kundërshtimet, parashtrës, ankesat, mosmarrëveshjet administrative që janë në dispozicion të palëve të pakënaqura me vendimin e autoritetit kompetent në procedurat e miratimit për qasje dhe kryerje të shërbimeve dhe mosmarrëveshjeve që mund të paraqiten midis dhënësit të shërbimeve ose ndërmjet dhënësit dhe pranuesit të shërbimit;
- Kontakt të shoqatave ose organizatave, të cilat nuk janë organe kompetente, e prej të cilave dhënësit ose shfrytëzuesit e shërbimeve mund të pranojnë ndihmë praktike.